



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.07.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për diskutimin e projektligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, propozim i një grupi deputetësh, me akademikë të Asamblesë së Akademisë së Shkencave dhe të Akademisë së Studimeve Albanologjike (*komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Vilma Bello, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Klajdi Qama.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Deputetë nismetarë:

Eglantina Gjermani, Evis Kushi.

Të ftuar:

Vasil Tole - përfaqësues i Akademisë së Shkencave,
Shaban Sinani - përfaqësues i Akademisë së Shkencave,
Neki Frashri - përfaqësues i Akademisë së Shkencave,
Ilirian Malollari - përfaqësues i Akademisë së Shkencave,
Kosta Barjaba - përfaqësues i Akademisë së Shkencave,
Emin Riza - përfaqësues i Akademisë së Shkencave,
Mereglen Verli - përfaqësues i Akademisë së Studimeve Albanologjike,
Redi Shtino - zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Faleminderit që jeni prezent në mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik!

Ashtu siç jeni në dijeni, ne do të fillojmë ta diskutojmë sot projektligjin “Për Akademinë e Shkencave”, që është nismë e një grupi deputetësh. Pasi grupi i deputetëve solli nismën, komisioni bëri dëgjuesën me grupin hartues dhe me grupin teknik, që kishte ndihmuar për hartimin e këtij projektligji dhe e kaloi për mendim në Këshillin e Ministrave. Përgjigjja nga Këshilli i Ministrave ka ardhur, kështu që ne jemi të lirë t’i fillojmë të gjitha dëgjesat me grupet e interesit.

Në planin tonë të punës ne kemi vendosur që në grupet e interesit të përfshihen akademikët, anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe të Akademisë të Studimeve Albanologjike, gjithashtu, rektoratet e universiteteve publike në të gjithë vendin, si dhe akademikë të pavarur. Kështu që në këtë seancë ne do të kishim nevojë të kishim mendime me shkrim të Akademisë së Shkencave dhe të Institutit të Studimeve Albanologjike.

Para se të fillojmë dëgjuesën, dua t’ju bëj me dije që kryetarja e komisionit për një arsye objektive do të vonohet edhe pak minuta dhe vjen gjatë dëgjuesës.

Dua t’ia jap fjalën zotit Ylli që të na thotë nëse kemi kuorumin e plotë për të filluar këtë mbledhje.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë, ne jemi 9 anëtarë, kështu që mund të vazhdojmë me dëgjesat e akademikëve.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Zoti Tola, nuk e di si e keni parashikuar ju, por në listën e shënimeve që kam këtu përveç jush do të jenë edhe zotërinjtë Shaban Sinani, Jorgaq Kaçani, Neki Frashri, Anastas Angjeli, Ilirian Malollari, Jani Vangjeli, Kosta Barjaba dhe Emin Riza. Nga Akademia e Studimeve Albanologjike do të jenë Marenglen Verli dhe Beqir Meta.

Ndërsa nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ne kemi thirrur që të ndjekë të gjitha seancat dëgjimore që do të zhvillohen për këtë projektligj zëvendësministrin përgjegjës për arsimin e lartë, zotin Redi Shtino.

Faleminderit!

Vasil Tole – Faleminderit!

Të nderuar zotërinj deputetë dhe zonja deputete,

Për shkak të kohës së shkurtër, sot një përfaqësi e akademikëve dhe Asamblesë së Akademisë së Shkencave e përbërë nga akademikët: Neki Frashri, Ilirian Malollari, Vasil Tole, Emin Riza, Shaban Sinani, Marenglen Verli dhe Kosta Barjaba marrin pjesë në këtë seancë dëgjimore. Faleminderit për mundësinë që na keni krijuar!

Zyrtarisht jemi shprehur në emër të Akademisë dhe e kemi depozituar pranë Komisionit të Medies mendimin tonë. Ju lutem, më lejoni që shkurtimisht të theksoj këto pika kryesore:

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 8 korrik, ju bëj me dije se Akademia përmes Asamblesë së Akademisë së Shkencave e konsideron veten të përfshirë tërësisht në procesin e hartimit të projektligjit nga grupi i punës, pasi ka pasur një bashkëpunim shumë të ngushtë midis grupit të ngritur me urdhër të ministres së Arsimit dhe grupit të ngritur nga Asambleja gjatë procesit të reformimit të institucionit tonë. Gjatë gjithë këtij procesi të gjitha sugjerimet dhe projektet alternative, si dhe mendimet e dhëna nga anëtarët e Asamblesë, dhe këtu kujtoj se, përpara se të vinim në procesin e hartimit të projektligjit, kaluam një periudhë 2-vjeçare diskutimesh, ku pothuajse 99% e anëtarëve të Asamblesë janë shprehur me projekte dhe mendime për të ardhmen e Akademisë së Shkencave, janë reflektuar në këtë draft që ju po shqyrtoni. Kjo është shprehur edhe me votën mbështetëse konsultative të 44 anëtarëve të Asamblesë me një votë kundër.

Përmbledhtazi, po ju japim disa nga arsytet se pse Asambleja dhe vetë Akademia e Shkencave si institucion e mbështet këtë projektligj.

Së pari, projektligji është konform standardeve europiane për organizimin dhe mirëfunksionimin e akademive të shkencave. Kjo ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me ALLEA-n dhe me Akademinë Kombëtare Gjermane “Leopoldina”.

Të nderuar kolegë, për dijeni, ALLEA për ne akademikët e botës shkencore është si Komisioni i Venecias për standardet ligjore në nivel evropian dhe më gjerë.

Së dyti, projektligji korrigjon praktikën e gabuara, deri edhe antikushtetuese, të konstatuara në aktet e mëparshme, duke garantuar respektim të plotë të parimeve dhe principeve të autonomisë dhe lirive akademike. Për shembull, ndër këto, kujtoj heqjen dhe

privimin nga drejta e votës për akademikët mbi 75 vjeç, referuar ligjit të vitit 2006 “Për Akademinë e Shkencave”.

Së treti, projektligji nuk është një kopjim i modelit të caktuar, por mbart dhe reflekton përvojat më të mira, si të ligjeve të mëparshme, veçanërisht të kuadrit ligjor të akademive simotra, kryesisht ato europiane, me të cilat kemi qenë në konsultim të vazhdueshëm gjatë gjithë këtij procesi.

Projektligji sjell një sërë përmirësimesh: përcaktimin e qartë të rolit dhe misionit të Akademisë së Shkencave; marrëdhëniet e komunikimit dhe bashkëpunimit të hapur të Akademisë me qendrat kryesore të kërkimit, me ILA-të e me institutet, si dhe me organet politikëbërëse për shkencën dhe kërkimin, posaçërisht marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave dhe me komisionin parlamentar, që mbulon shkencën dhe kërkimin shkencor.

Projektligji urdhëron përcaktimin e kritereve dhe procedurave rigoroze për anëtarësimet e reja me pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e institucioneve të tjera; i hap rrugë freskimit të përbërjes së Asamblesë së Akademisë. Nëpërmjet pranimeve të tjera, parashikimi ynë është mbi 15 pranime në dy vjetët e ardhshëm. Për herë të parë përcakton me ligj krijimin e akademisë së të rinjve, si dhe pjesëmarrjen e shkencëtarëve të rinj në mënyrë aktive në komisione dhe Asamblenë e Akademisë dhe bën një hap para, për hir të së vërtetës, një hap i munguar deri tani, drejt respektimit të barazisë gjinore.

Së pesti, gjithashtu, projektligji hedh një hap cilësor për sa i takon krijimit të hapësirave ligjore për ngritjen e qendrave të kërkim-studimit pranë Akademisë së Shkencave, duke i dhënë akademisë një rol proaktiv dhe jo thjesht deklarativ, i munguar deri tan i në kryerjen e misionit të saj.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i projektligjit është se ai krijon hapësirat e duhura të hapjes për diasporën shkencore dhe ndaj akademikëve dhe mendimit akademik shqiptar në rajon, duke mundësuar që Akademia të luajë një rol primar në zhvillimin e shkencave të Albanologjisë dhe të identitetit kombëtar, si dhe të ndikojë në përfshirjen aktive të studiuesve më të suksesshëm jashtë vendit në kryerjen së bashku me ta të misionit dhe qëllimit që ka Akademia e Shkencave, referuar këtij ligji dhe pritshmërisë së opinionit të gjerë për rolin e Akademisë dhe akademikëve në dijen e shoqërisë.

Të nderuar deputetë, këto ishin përmbledhtazi ato që doja të thosha!

Sinqerisht, falënderojmë komisionin, në mënyrë të veçantë grupin e deputetëve nismëtarë, duke u ofruar mbështetjen dhe bashkëpunimin tonë maksimal deri në përfundim të këtij procesi.

Po ashtu, në emër Akademisë shprehim vlerësimet tona për sugjerimet e Këshillit të Ministrave përmes VKM-së nr. 394, datë 19 qershor, me të cilin Akademia shprehet në parim dhe parimisht dakord.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zoti Tola!

Dua që këto komente, që ju thatë, të na i depozitoni me shkrim në sekretari për t'i përdorur si komisioni, ashtu edhe grupi nismëtar i deputetëve.

Sot këtu kemi 3 nga deputetët nismëtarë, që po ndjekin me vëmendje seancën e sotme, për t'i marrë në konsideratë të gjitha shënimet. Ndërkohë, në qoftë se i referohemi vendimit të Këshillit të Ministrave në lidhje me kërkesën që bëri komisioni për analizën e projektligjit për Akademinë e Shkencave, një nga kërkesat që ka VKM-ja është se duhet ta elaburojmë pak më tej strukturën e re të Akademisë dhe mbështetjen financiare që kërkon struktura e re. Ju keni sjellë një përgjigje me shkrim për këtë gjë, ndërkohë komisioni do ta bëjë edhe një herë kërkesën që mbase ajo shuma, që ju keni përshkruar, të ishte bërë sipas zërave buxhetor. Do të ishte më e udhës që të ndahej në këtë formë përgjigjja që ju është kërkuar nëpërmjet asaj VKM-je, duke dhënë organigramën dhe strukturën e pagave si ishte dhe si bëhet.

Vasil Tole – Është e vërtetë që ne kemi kthyer përgjigje me shkrim dhe është depozituar tashmë, pas shprehjes së Këshillit të Ministrave për këtë çështje. Në rast se komisioni e gjykon të arsyeshme që ta hedhim edhe këtë hap, pra për një propozim strukture paraprake brenda numrit të përgjithshëm të 29 punonjësve që kemi, duke theksuar faktin që nuk ka efekte financiare, sigurisht që ne e bëjmë, por, me sa kam parasysh, në projektligj është parashikuar që organika e re shprehet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe aprovet paraprakisht nga Asambleja. Gjithsesi, ne jemi të hapur për ta diskutuar këtë gjë edhe pas këtij takimi.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Kolegë, a keni ndonjë pyetje në lidhje me opinionin që ka Akademia për projektligjin?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dëgjojmë edhe Akademinë e Studimeve Albanologjike.

Mereglen Verli – Të nderuar deputetë, flas në emër të Akademisë së Studimeve Albanologjike, e cila në biografinë e saj ka 10 vjet me këtë riorganizim.

Për sa i takon asaj që tha profesor Tole, në përgjithësi nuk kam se çfarë të shtoj, sepse edhe unë dhe kolegët e mi kemi të njëjtin mendim. Akademia ka pasur një situatë të pastabilizuar edhe për shkak të ngacmimeve nga jashtë saj gjatë periudhës së fundit. Mendoj

se në këtë mënyrë vendoset në pozicionin e duhur çdo gjë, e cila ishte nismë e deputetëve për të startuar në këtë proces dhe me mbështetjen e parlamentit do të marrë vulën përfundimtare.

Për sa i takon Akademisë së Studimeve Albanologjike, në takimin e fundit që pata nderin të kem me ju në nëntor të vitit të kaluar, unë dorëzova një material të plotë, gati 15 faqe, ku kam shtruar probleme, tregoja arritjet dhe atë çfarë na pengon për të zhvilluar më tej studimin në fushën e albanologjisë. Ndër të tjera, ka një ngecje në kuadrin ligjor. Ligji i arsimit të lartë, ku ne bëjmë pjesë prej dy vjetësh, nuk ka marrë parasysh specifikën e institucionit tonë lidhur me kualifikimin e kuadrove në drejtim të gradës “profesor” dhe të drejtën për të iniciuar këtë gradim të kuadrit profesional, i cili, pa modesti, mund të themi që është nga më të kualifikuarit në Republikën e Shqipërisë, kudo në sektorët e arsimit të lartë.

Gjithashtu, ka edhe probleme të vogla, që kanë të bëjnë me një shtesë të financave në drejtim jo të një gjëje të re, por në zbatim të ligjit, që ka të bëjë me honorarët, e cila do t'i jepte mundësinë profesoratit më aktiv të diferencoj nga pjesa tjetër, ku profesori të nxitej, të ishte aktiv në prodhimtarinë shkencore dhe të arrinte atë që profesori gjatë jetës së tij si studiues ta mbyllte karrierën me disa dhjetëra libra dhe jo me disa libra.

Edhe problemet e tjera që ne kemi, i kam dorëzuar te ju para disa muajsh, ku ndër të tjera trajtohet edhe problemi i miratimit të një varg projektsh që ne dorëzojmë vit pas viti dhe që, natyrisht, është detyra e eprorëve tanë të zgjedhin më të vyerat, ato ku shteti ka përparësinë dhe ne, me kuadrin e kualifikuar që kemi, të përgjigjemi në të gjitha fushat, duke filluar që nga arkeologjia, historia, gjuha dhe antropologjia.

Unë bashkohem me ato që tha profesor Tole.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri- Përshëndetje!

Ndjesë për vonesën!

Dëshiron njeri të marrë fjalën? Po, urdhëroni!

Shaban Sinani– Mirëdita të gjithëve!

Ju falënderoj që më dhatë mundësinë të flas këtu!

Akademia e Shkencave ka ardhur me një mendim institucional, që u paraqit nga akademiku Tole, por unë thjesht doja të rikonfirmoja disa prej vlerave që ka ky projektligj.

Së pari, sipas mendimit tonë, që jemi pjesë e hartimit të këtij projekti, ky është një dokument ligjor, që i jep mundësi Akademisë së Shkencave të vetëreformohet pa ndërhyrjen e një autoriteti tjetër, siç ka ndodhur jo rrallë herë më parë.

Së dyti, ky projekt hap Akademinë e Shkencave ndaj sistemit kërkimor-shkencor në vend, e ndërlidh me veprimtarinë universitare, qoftë publike ose jo, i jep rëndësi parësore

njësisë shkencore themelore, ku zhvillohet veprimtaria kërkimore, duke përfshirë promovimin e kandidaturave që konkurrojnë dhe siguron përtëritjen e Asamblesë së Akademisë, që është plaga më e rëndë e deritanishme e këtij institucioni, të cilës jo vetëm që i mungojnë 15 anëtarë, por ligji ekzistues nuk i jep mundësi për të vazhduar përtëritjen. Ligji ekzistues, siç është provuar prej më shumë se 10 vjetësh, ka dhënë mundësi që kandidatët konkurrues të hyjnë në garë dhe të humbin, dhe jo të hyjnë në garë e të fitojnë. Ky ligj e ndryshon rrënjësisht këtë pamje.

Unë mendoj se mënyra se si janë rregulluar raportet midis kërkimit shkencor në Akademinë e Shkencave dhe rolit të këtij institucioni me kërkimin shkencor jashtë, ka një paritet të drejtash. Akademia e Shkencave i njeh vetes disa detyra dhe funksione që kanë të bëjnë jo vetëm me strukturën e saj, që ky institucion të mos jetë më një bunker, siç është shndërruar, por të jetë pjesë ndërvepruese në të gjithë jetën kërkimore - shkencore të vendit dhe autoriteti i anëtarëve të Asamblesë së Akademisë të rritet aty ku zhvillojnë jetën shkencore.

Një pikë tjetër e rëndësishme në këtë projektligj është ndarja e drejtimit administrativ nga ai shkencor, rritja e rolit të asamblesë, që bëhet autoriteti më i rëndësishëm vendimmarrës në këtë institucion, delegimi i të drejtave nga kryesia te seksionet, që tashmë marrin një rol krejt të ri dhe demokratizimi e hapja e institucionit.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Sinani!

Kush e do fjalën? Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Faleminderit për prezantimin, të nderuar profesorë!

Unë ju kërkoj ndjesë, sepse isha në Komisionin e Integritetit, ndoshta humba një pjesë të shpjegimeve dhe nuk e di nëse janë shteruar pyetjet që unë dua të bëj. Gjithsesi, unë dua të bëj dy pyetje, që i kam merak dhe nuk janë pyetje të reja për ju, pasi janë pika të ngritura, me shumë të drejtë, në opinionin që na ka ardhur nga Këshilli i Ministrave lidhur me projektligjin.

Unë përgjithësisht jam dakord me të gjitha sugjerimet, propozimet, por edhe vërejtjet e ardhura nga Këshilli i Ministrave. Ato që më shqetësojnë më shumë janë dy nene. Së pari, neni 5, konkretisht pika 15, ku sipas projektligjit thuhet se Akademia e Shkencave ka të drejtën e monitorimit të procesit kërkimor, i cili kryhet në të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Kjo bie në kundërshtim me ligjin e arsimit të lartë dhe unë nuk e shoh rolin e Akademisë si një piramidë kontrolluese të të gjithë kërkimit shkencor, i cili duhet të ketë absolutisht pavarësinë e vet akademike në çdo lloj institucioni dhe nuk ka pse të marrë

certifikimin në Akademi. Ky është një parim i njohur në të gjitha vendet e tjera të Europës Perëndimore. Nuk e di nëse zoti Tole e ka dhënë shpjegimin për këtë nen?!

Shqetësimi i dytë ka të bëjë me pikën 8, të nenit 9. Në këtë pikë të nenit 9 të projektligjit u jepet e drejta anëtarëve të asamblesë që të jenë pjesë e senateve akademike në institucionet e arsimit të lartë. Këtë e gjej krejtësisht pa vend, sepse, përderisa kemi një ligj që e përcakton shumë qartë se si bëhesh anëtar i një senati përmes procesit të zgjedhjeje, nuk e di pse duhet të kemi një kundërvënie të tillë. Të dyja këto kanë të bëjnë me parimin e pavarësisë akademike të institucioneve të arsimit të lartë, të cilat nuk e di pse duhet të kenë kushte të privileguara për Akademinë e Shkencave.

Vasil Tole – Faleminderit, zonja Kumbaro!

Në fakt, ne kemi kthyer përgjigje për dy shqetësimet që ju ngritët, sepse i kemi analizuar rast pas rasti. Dua të them shkurtimisht dy gjëra. Duhet të jetë e qartë për të gjithë deputetët që Këshilli i Ministrave, me të cilin kemi pasur një bashkëpunim shumë të frytshëm, në asnjë rast nuk ka përmendur fjalën “vërejtje” për projektligjin. Në qoftë se i referoheni paragrafit të fundit të vendimit, ai thotë: “sugjerimet e mësipërme”...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord. Vërejtja besoj se është diçka më serioze, ndërsa sugjerimet duhet t'i diskutojmë dhe të jemi më të hapur.

Dua të shpjegoj se si kanë ardhur këto dy sugjerime. Me sugjerim të Kryeministrit, në shtator të vitit të kaluar kur ai vizitoi Akademinë, ai pohoi se që në atë moment projektligji ka qenë gati për të kaluar për aprovim dhe, kur bëri sugjerimin për të parë edhe njëherë të fundit nëse ka variante alternative për t'u përfshirë, grupi i punës, më kujtohet që në atë periudhë ka qenë zonja Lindita ministre, bëri përpjekjen e fundit për t'i integruar në këtë projektligj edhe mendimet alternative. Pikërisht, pika 13 është një pikë e huazuar nga platforma e akademikut Fuga, i cili e kërkoi këtë gjë dhe ne e morëm tekstualisht, siç ishte në platformën e tij dhe e vendosëm në këtë pikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po flasim për sugjerimin e parë që bëtë, ku thuhet: “të orientojë fushat prioritare edhe në lidhje me kërkimin shkencor.”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pra, që nga pika 13 deri te pika 15, të tria këto pika janë marrë *mot à mot* nga platforma alternative. Qëllimi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, pra, po jua them si është. Ne menduam që, duke qenë se alternativa është gjithnjë diçka interesante për pasurimin e projektligjit, t'i vendosim si një shenjë afrimi dhe bashkëpunimi edhe më shumë me ILA-të. Kjo është e vërteta e kësaj. Ndërkohë, në përgjigjen që ne kemi kthyer, jemi të hapur që këtë çështje ta vendosim me mirëkuptim, pra nuk insistojmë që të jetë detyruesisht kështu ose...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Sa për procedurë, ne e kemi ndarë edhe punën në komision, por po ju dëgjojmë dhe po i marrim shënim të gjitha komentet tuaja. Pas dëgjësave fillon puna në komision nen për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kështu që do të duhet që dikush nga ju, nga grupi nismëtar dhe nga Ministria e Arsimit, të jetë prezent në punën e komisionit nen për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndërhyrjen e pata vetëm për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasil Tole – Faleminderit!

Atëherë, në këtë rast do të ishte mirë që grupi i punës i përbërë nga, më lejoni t'i citoj emrat: akademikët Skënder Gjinushi, Luan Omari, Shaban Sinani, Kosta Barjaba, Beqir Meta dhe Apollon Baçe, të njoftohen dhe ata të vendosin se cilët do të jenë kolegët që do t'i ndjekin këto.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Kumbaro, në lidhje me çështjen e dytë, pra me qenien *ex officio* të akademikut në një senat akademik, ne jemi të qartë për sa i përket faktit që mund të tingëllojë edhe kështu, siç e thoni ju, pra që krijon një problem në raportet me autonominë e të tjera, por ne e gjejkojmë kështu: në kuadrin e një akademie të re, të rindërtuar, ku thelbi i hapjes së akademisë është ndaj botës universitare, ku në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit ne të ndërtojmë, le të themi, të gjithë hapat institucionalë se si kandidohet për t'u bërë anëtar i Akademisë së Shkencave. Propozimet kryesore do të vijnë kryesisht nga departamentet, nga këshillat e fakulteteve dhe nga senatet. Ne e çmojmë të arsyeshme që Akademia nuk ka resurse të tjera të vetat përveç këtyre autoriteteve, të cilët ushtrojnë funksionet e tyre në universitete.

Propozimi ynë ka të bëjë pikërisht me ata profesorë, të cilët vazhdojnë të japin mësim. Ja ku i kemi disa prej tyre: akademikët Neki Frashëri, Ilirian Malollari, Marenglen Verli, të cilët janë njëkohësisht profesorë dhe akademikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre nëpër

universitete. Ne çfarë propozojmë? Propozojmë që për shkak të titullit “Akademik”, që e kanë fituar po në ato universitete, ku, për fat, janë zgjedhur dekanë, shefa departamentesh, ta gëzojnë këtë të drejtë, *ex officio*, pra për shkak të titullit, si një shenjë ndërlidhëse.

Ne jemi të hapur që këtë çështje ta diskutojmë qoftë edhe duke mos i dhënë të drejtën e votës, pasi nuk duam të përmbysim raportet. Ne duam thjesht të ndërtojmë një urë komunikimi, ku të kemi mundësi që anëtarët e Akademisë të jenë të përfaqësuar edhe në institucionet universitare, sepse, praktikisht, sot ne jemi tërësisht të izoluar nga kjo gjë; nuk komunikojmë dot.

Arsyeja jonë është thjesht se si të koordinojmë sa më mirë, si të jemi në dijeni të planeve të njëri-tjetrit nëpërmjet një përfaqësimi, që do ta quaja proporcional: u japim të drejtën që të propozojnë kandidaturat për t’u bërë anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe ato kandidatura, të cilat finalizohen, se janë ndërkohë profesorë... Ne nuk po themi që një akademiku, për shembull, profesor Rizës, më falni se po ju marr si shembull, i cili është në pension aktualisht, t’i themi që, për shkak se është akademik, ta çojmë *ex officio* anëtar senati. Jo, ne po themi që akademikët, të cilët janë në jetë aktive universitare, që janë profesorë, siç jam edhe unë profesor tek Universiteti i Arteve, pra vazhdoj të jap mësim, do ta quaja nder të përfaqësohesha në senatin e Universitetit të Arteve, si shenjë e ndërthurjes së jetës institucionale të të dyja institucioneve tona. Ky është qëndrimi ynë.

Më falni edhe për tonin, pasi jemi nisur singlerisht për të bërë diçka të mirë, jo për të ngatërruar punë!

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Të vijoj unë? Atëherë, zoti Tole, kemi një kthim përgjigjeje nga ana juaj lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e Këshillit të Ministrave. Aty ku theksohet “Mendimi ynë, mendimi juaj, i kryesisë”, mungon një procesverbal mbledhjeje nga ana juaj, i Akademisë. Madje, nuk kemi një numër protokolli, një datë se kur është mbledhur kjo kryesi, sipas jush e konstituuar, dhe cilët kanë qenë pjesëmarrës në këtë kryesi.

Pra, së pari, mungon procesverbali i mbledhjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gjithsesi.

Së dyti, te sqarimi “Numri i përgjithshëm i anëtarëve është 30 plus 10, 40 anëtarë të asamblesë. Në të nuk përfshihen anëtarët mbi 75 vjeç”, kam një pyetje: cilat janë dy përkufizimet apo çfarë do të bëhet me dy përkufizimet juridike të rëndësishme se cilët do të quhen, sipas këtij ligji, akademikë që zgjidhen dhe ata që do të zgjedhin?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasil Tole – Zonja kryetare, në lidhje me atë që ju e quani procesverbal i mbledhjes, më lejoni t'ju informoj për një çështje: këto nuk janë mendimet e kryesisë së Akademisë. Kryesia e Akademisë në këtë rast, unë, si zëvendëskryetar i Akademisë, sepse kryetari, siç e dini, është ende në proces të pritjes së dekretimit nga Presidenti, përcjell te ju mendimet e grupit të punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këto, që ne ju kemi përcjellë zyrtarisht, janë mendimet e grupit të punës, të cilët janë edhe autorët e këtij projektligji. Kjo ishte për sa i përket pikës së parë.

E kemi theksuar edhe më parë çështjen e raportit 30 plus 10, ku 30 janë anëtarë të rregullt të asamblesë, me statusin e akademikut të rregullt, ndërsa 10 janë anëtarë të asamblesë, me statusin e akademikut të asociuar, dhe në këtë numër nuk përfshihen akademikë me moshë 75-vjeçare për një arsye shumë të thjeshtë, atë të lirimit të vendeve për anëtarët e rinj.

Më lejoni t'ju shpjegoj më konkretisht, edhe si juriste që jeni.

Ligji i vitit 2006 ka pasur një shkelje të rëndë kushtetuese, pasi kufizohej me ligj, gjë të cilën e rrëzoi më pas me vendim të posaçëm Gjykata Kushtetuese në vitin 2008, pra pikërisht nonsensi juridik që anëtarët mbi 75 vjeç nuk kishin të drejtë vote. Ndërkohë, aktualisht ne e kemi fituar këtë të drejtë falë vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Pra, 40-a është numri i anëtarëve, ku në të përfshihen edhe akademikët mbi 75 vjeç, të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë në votime, kur kanë dëshirë për të ardhur për të votuar, por nuk llogariten në numrin e përgjithshëm të anëtarëve të Asamblesë së Akademisë së Shkencave. Kjo është logjika, siç e thashë edhe më parë, që na e ka detyruar vendimi i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2008. Në rast se dëshironi, mund ta depozitoni edhe vendimin pranë sekretarisë së komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Lidhur me relacionin financiar, përsëri relacioni ose efektet financiare të paraqitura nga ana juaj janë të vakëta në këtë lloj mendimi.

Lidhur me efektet financiare në buxhet për sa i përket Akademisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëroni!

Vasil Tole – Ju erdhët me pak vonesë, por zonja nënkryetare e komisionit e sqaroi që në lidhje me çështjet financiare, pavarësisht sqarimit që kemi dhënë ne, të ulemi pas përfundimit të kësaj seance dëgjimore me personat e interesuar. Megjithatë, është e

rëndësishme për ju, si kryetare, që ta theksoj posaçërisht që projektligji nuk ka efekte financiare. Pra, ne mund ta riorganizojmë strukturën tonë administrative të Akademisë së Shkencave brenda fondit të pagave dhe brenda të gjithë buxhetit që i ka dhënë qeveria.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, nuk do të kërkojmë para shtesë për sa i përket riorganizimit që do të bëjmë si institucion.

Jemi të gatshëm, e ritheksoj, madje të më falin deputetët që ishin këtu, që ta shprehim më qartë për komisionin çështjen e buxhetit dhe të riorganizimit të strukturës së re të Akademisë.

Fatjona Dhimitri – Lidhur me rolin dhe funksionet kryesore të Akademisë, në projektligj theksohet: “të kontribuojë në përgatitjen dhe promovimin e shkencëtarëve të rinj”. Sipas jush, a kthehet Akademia e Shkencave apo merr pak a shumë një rol formimi universitar?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A kthehet në institucion arsimor, sipas këtij projektligji?

Vasil Tole – Fjala “promovim” nënkupton që shkencëtarët e rinj e kanë mbyllur të gjithë ciklin e edukimit dhe, në momentin kur shfaqin tendencat e para për t’u marrë me kërkim shkencor të avancuar, u vjen në ndihmë Akademia. Ne tashmë e kemi ndërtuar një model. Pranë nesh funksionon prej tre vjetësh Akademia e të Rinjve, ku është grumbulluar një grup prej 18 doktorësh dhe profesorësh të asociuar poshtë moshës 45 vjeç, të cilët po e provojnë mirë se çfarë do të thotë promovim i shkencëtarëve të rinj, ashtu siç e kemi shkruar në projektligjin që ju keni përpara.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Ju lutem!

Te neni 9 thuhet: “Anëtarët *emeritus* lirohen nga detyrimet e pikës së dytë, nga e drejta për t’u zgjedhur në organet drejtuese”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Na jepni një shpjegim, ju lutem, lidhur me këtë pikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për pikën 11, të nenit 9.

Vasil Tole – Më falni, se na ngatërron thjesht çështja e termit, pasi deri tani i kemi quajtur akademikë mbi 75 vjeç, ndërkohë që në projektligjin e ri i kemi quajtur akademikë *emeritus*. Pra, do të thotë që akademikët mbi 75 vjeç nuk janë të detyruar me ligj që të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë. Pra, edhe këtë e kemi marrë nga statutet e Akademisë së

Shkencave të Austrisë dhe disa vendeve të Europës. Për shkak të moshës ata mund ta çmojnë vet të arsyeshme. Nuk mund t'i them, më falni që po i përmend emrin, Ismail Kadaresë që të marrë pjesë patjetër në mbledhjen e Asamblesë.

Pra, ata e kanë në vullnetin e tyre ta çmojnë sipas rastit. Më lejoni t'ju përmend rastin e fundit, meqë ju dëgjova në një prononcim publik për zgjedhjet e Akademisë, ku Ismail Kadare dhe 43 kolegë të Akademisë e çmuan që duhet të merrnin pjesë në zgjedhjet e Akademisë dhe erdhën e ushtruan vullnetin, por ne nuk ju bëmë presion për të votuar. Kuptimi i pikës 11 është që anëtarët *emeritus* kanë të drejtën e tyre ta çmojnë... Janë shumë personalitete, 10 prej tyre, që nuk është nevoja t'i përmend tani ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, votë vullnetare.

Thelbi është që nuk i detyron dot.

Ata që janë anëtarë të rregullt e kanë me detyrim të vijnë, sepse, në fund të fundit, ky projektligj për 40 anëtarë të rregullt të Asamblesë bëhet.

Fatjona Dhimitri – Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Asamblesë: “Të japin ekspertizë dhe këshillime për institucionet shtetërore dhe ato publike të shkencës dhe arsimit”. Lejohet një gjë e tillë, zoti Tole?

Vasil Tole – Më fal, ma thoni edhe një herë pikën?

Fatjona Dhimitri - Neni 9, pika 7: “Të japin ekspertizë dhe këshillime për institucionet shtetërore dhe ato publike të shkencës dhe arsimit”. Lejohet dhënia e ekspertizës dhe këshillimeve?

Vasil Tole – Nuk lejohet mosdhënia e ekspertizës, sepse ne jemi institucion ... Madje, na ka ardhur keq që çështja e tensionuar në Akademinë e Shkencave është bërë publike.

Zonja kryetare, ne marrim vendim vetëm për veten tonë. I vetmi vendim që merr Akademia e Shkencave është kur pranon anëtarët e vet. Gjithçka tjetër ne e lëmë në dorë të institucioneve të politikës. Një politikë e kulturuar dhe e ndërgjegjshme, që qeveris me shkencë dhe kulturë, mund ta marrë mendimin e Akademisë dhe do të jetë e nderuar. Pra, detyra jonë kryesore është të themi dhe të jemi në gjendje që, në çdo moment që qeverisja dhe institucionet do të kërkojnë mendimin tonë, ne t'i themi “po, kemi mendim për naftën, për arkitekturën, për kulturën, artin, bujqësinë, ekonominë”. Ky është një nga funksionet tona kryesore, që ndoshta mund të kalonte në ndonjë pikë më sipër, jo aty ku është.

Fatjona Dhimitri – Neni 3.

Akademia është institucioni publik më i lartë që përfaqëson e bart vlerat më të mira të shkencës, kërkimit shkencor, krijimtarisë dhe debatit.

Zoti Tole, ne nuk kemi një sistem piramidal të kërkimit shkencor.

Vasil Tole – Unë nuk kam idenë që ne kemi një sistem piramidal, por vetiu, ju ligjvënësit keni krijuar një sistem të tillë. Në rast se do t'i referoheni strukturës së titujve dhe gradave shkencore, që fillojnë nga master profesional, master shkencor, doktor i shkencave, profesor i asociuar dhe profesor me titullin e akademikut, vetiu, institucioni që grumbullon në një institucion të vetëm të gjithë ata pak njerëz me titullin “akademik”, sepse për hir të së vërtetës ne jemi pak, kjo është arsyeja që edhe pse mund të jemi cilësisht lartë, në pikëpamje sasiore ne nuk ndikojmë dot në vendimmarrje, është Akademia e Shkencave. Ligji jep të drejtën që titujt më të lartë të evidentohen, duke krijuar një institucion të posaçëm siç është edhe ligji për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Pra, ne nuk kemi pretendimin që jemi më të mirë se të tjerët, por për shkaqe të mbajtjes së titullit akademik, ky institucion e meriton të jetë dhe të formulohet kështu siç është në pikën 1 të nenit 3. Kështu e kanë formulimin të gjithë akademitë e shkencave në Europë.

Fatjona Dhimitri – Për sa i përket funksionit dhe rolit të Akademisë, është të orientojë fushat dhe nënfushat prioritare në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse.

Zoti Tole, me çfarë tagri e monitoroni kërkimin shkencor, doktoraturat?

Vasil Tola – Zonja kryetare, unë u përgjigja për këtë çështje, por ju nuk ishit këtu. Jemi të hapur ta diskutojmë formulimin që komisioni do të ...

Fatjona Dhimitri – Kam një pyetje për grupin nismëtar. Çfarë risish sjell ky projektligj në gjendjen aktuale të Akademisë në raport me ligjin e vjetër?

Vasil Tole – Për t'ju kursyer kohë, mund t'ju jap materialin, të cilin edhe e lexova?

Fatjona Dhimitri – Dakord.

E do ndokush prej akademikëve fjalën?

Po, urdhëroni!

Redi Shtino – Përshëndetje!

Përfaqësoj Ministrinë e Arsimit.

Për të mos ndërprerë komunikimin, për sa kohë është Akademia ajo që raporton, shqetësimin e deputetes Kumbaro e ndajmë edhe ne si ministri.

Së pari, diskutimi thelbësor këtu përqendrohet në argumentimin e aspekteve financiare, ndërkohë që Ministria e Arsimit ka komentet e veta për përmbajtjen e ligjit të Akademisë së Shkencave. Së pari, për mundësinë e mbivendosjes së mundshme me ligjin e

arsimit të lartë dhe kjo është shumë shqetësuese. Do të na duhet të qendrojmë më në detaje, por në parim ky është shqetësimi bazë.

Pra, sa mbivendoset ky projektligj me ligjin në fuqi të arsimit të lartë dhe çfarë mendimesh do të sillte nëse ligji do të kalonte kështu për ligjin e ri të arsimit të lartë?

Fatjona Dhimitri – Dëshiron dikush nga akademikët të marrë fjalën?

Vasil Tole – Dua të them diçka për këtë që tha zoti Shtino. Çështjen e dhënies së mendimit qeverisë ne e quajmë të ezauruar pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave. Ndërkohë, jemi të hapur që në rast se ka çështje të tjera për diskutim, në një grup të përbashkët me komisionin ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Shtino, Këshilli i Ministrave ka hyrë nen për nen. Nuk ka thjesht një shkresë të Ministrisë së Financave që ka apo jo efekte. Për këtë gjë falënderoj Këshillin e Ministrave, sepse është shprehur nen për nen. Ju lutem, i diskutojmë më mirë mbyllur në grupin e vogël, nëse ka ndonjë shqetësim.

Fatjona Dhimitri – E do dikush tjetër nga profesorët fjalën?

Ka pyetje? Po, urdhëroni, zoti Nasufi.

Fadil Nasufi – Së pari, dua të falënderoj të gjithë panelin e akademikëve që dhanë sqarime shteruese për projektligjin!

Gjithashtu, dua të falënderoj dhe t'u shpreh mirënjohjen grupit të deputetëve nismëtarë që iniciuan një ligj të tillë! Na bëhet nder të gjithëve që të kalojmë në parlament një ligj të tillë për tempullin e shkencës dhe të kulturës, që, fatkeqësisht, ka një imazh shumë të dëmtuar.

Kështu që, apeli i parë është që duhet të ndërgjegjësohemi si shoqëri dhe institucion për rolin që duhet të ketë Akademia e Shkencave dhe për imazhin që duhet të ketë ky institucion, që është elita e kombit dhe ku janë personalitetet më të spikatura të kombit.

Së dyti, nga përvoja ime si drejtues vendor, duhet të kuptoni se sa me peshë është roli kur bashkëpunon me Akademinë.

E mora fjalën jo pa qëllim. Dua të falënderoj publikisht profesor Emin Rizën, i cili ka udhëhequr dosjen e Beratit në UNESCO, së bashku me një grup tjetër profesorësh të nderuar. Gjithashtu, janë realizuar një sërë sesionesh shkencore, ku kam pasur nderin të kem në Berat profesorët Shaban Sinani, Mareglen Verli, të ndjerin Jorgo Bullo, e kështu me radhë. Nga pikëpamja profesionale dhe asistencë shumë e specializuar ata arritën të sensibilizojnë institucionet ndërkombëtare që Berati të përfshihet në UNESCO. Dje ishte 11-vjetori i

pranimit të Beratit në UNESCO. Po e bëj këtë jo thjesht për mirënjohje, por për ta lidhur me aktualitetin dhe se si duhet të ngrihet në pedestal roli i Akademisë së Shkencave.

Së dyti, kam edhe një ndjesi të keqe. Kam ndjekur aktivitetin e Akademisë së Shkencave në një godinë tepër të rrënuar. Janë bërë aktivitete elitë, janë nderuar personalitete, janë ndarë çmime, por kam vënë re mungesë të medias, që është mungesë e ndjesisë dhe ndërgjegjes për të ndjekur vlerat shkencore dhe promovimet që bën ky institucion shkencor. Fatkeqësisht, kam parë edhe mungesë personalitetesh dhe autoritetesh politike në aktivitetet e Akademisë së Shkencave. Ky është një apel reflektimi, jo thjesht që të bëjmë një ligj të mirë, por të ndryshojmë pak mendjet dhe të jemi shumë të hapur dhe vlerësues ndaj institucionit të Akademisë së Shkencave.

Shumë mirë që ky ligj e vetëreformon këtë institucion. Profesorët Tole, Shabani dhe të tjerë dhanë shpjegime plotësuese në bazë të gjithë dokumentit të paraqitur dhe është shumë mirë që Këshilli i Ministrave i është referuar nen për nen.

Unë e shikoj të arsyeshme që, pas dëgjësës së sotme, aktorët e përfshirë në hartimin e projektligjit duhet të ulen që të integrojnë komplet ndërhyrjet, sqarimet teknike dhe teknikën e duhur ligjore, për të pasur draftin e plotë, që i jep përgjigje gjithë reformimit të Akademisë dhe gjithë problematikave të mbartura, si dhe rrugës së re. Unë dua të nxis kurajën e shumë intelektualëve, të cilët e morën vete në dorë këtë, jashtë çdo procedure dhe komisioni qeveritar apo procedurave të tjera politike, që e kanë përbaltur Akademinë e Shkencave me mesazhe politike

Me këtë po jap një mesazh, duke i falënderuar për të gjithë punën dyvjeçare që kanë bërë, për të gjithë vëmendjen dhe produktin që po na sjellin. Ta përpunojmë teknikisht që ta çojmë në seancë plenare dhe sa më shpejt ta kalojmë në seancë plenare, më shumë nder i bëjmë shpejtësisë për ta futur Akademinë e Shkencave në rrugë të mbarë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Nasufi!

A ka ndonjë nga anëtarët e komisionit që dëshiron të shtojë diçka?

Po, urdhëroni!

Ismet Beqiraj – Profesor, ju faleminderit për mendimet e vyera që dhatë në këtë dëgjësë, e cila i shërben deri në fund, pa u lodhur, vetëreformimit të Akademisë së Shkencave. Unë kam fatin të jem relator i këtij projektligji të rëndësishëm dhe dua të shpreh disa refleksione që kam parë dhe lexuar për të gjithë punën dhe veprimtarinë tuaj në këta dy vjet. Më ka bërë përshtypje serioziteti, korrektësia dhe përgjegjësia me të cilën kanë punuar me detyra qartësisht të përcaktuara dhe në respekt të afateve kohore, anëtarët e grupit

nismëtarë *ad hoc*, Ministria e Arsimit dhe Akademia e Shkencave. Sipas urdhrit të ministres për ngritjen e këtij grupi pune, ju e keni realizuar draftimin e projektligjit brenda datës 30 mars 2018, ku gjatë gjithë kësaj periudhe janë përfshirë të gjithë aktorët, palët e interesit, sidomos aktorët e kërkimit shkencor dhe të studimeve brenda dhe jashtë Akademisë në institucionet e kërkimit shkencor dhe në institucionet e arsimit të lartë. Në këtë projektligj ka një gjithëpërfshirje të të gjithë mendimit akademik të asamblesë. Jo vetën kaq, por jeni përpjekur të integroni në këtë projektligj edhe mendimet ndryshe deri në fund, në mos u gabofsha deri në 5 nëntor të vitit 2018 dhe, më pas, morët vendim prestigjioz, që ju nderon.

Reformimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë pas 30 vjetësh, që, me të drejtë e tha edhe Kryeministri, i ngjan një nëndetëseje që ka mbetur në rërë dhe me këtë vetëreformim, ku ju patët vullnetin dhe forcën të ringriheni nga gjithë kjo *status quo* 30-vjeçare, ka ardhur koha që nëndetësja të dalë, të shkulet nga rëra dhe të hidhet në detet dhe oqeanet e kërkimit shkencor, e të gjithë botës akademike në shërbim dhe në interes të shqiptarëve dhe kombit shqiptar.

Nga ana tjetër, është i vetmi institucion kërkimor-shkencor elitë, që do t'i hapë rrugën edhe reformimit të institucioneve të tjera të kërkimit shkencor në vend. Pra, jo vetëm bën një vetëreformim, por sjell vlerat më të mira dhe standardet me të mira. Shoqata Akademike Europiane, ALLEAS dhe Akademia Gjermane kanë bërë një certifikim të standardeve europiane dhe jo vetëm që nuk e kanë trajtuar thjesht si ligj në kornizë lidhur me parimet, por janë futur edhe nën për nën në hollësi, në mënyrë analitike, duke ndihmuar me mendimet e tyre. Ju keni në dorë një certifikatë të plotësimit të standardeve europiane të dy institucioneve prestigjioze në Europë.

Lidhur edhe me mendimet që ka dhënë Këshilli i Ministrave, ju jeni treguar prapë të gjerë në përgjigjet tuaja, që të diskutohen deri në fund dhe të reflektohen në draftin përfundimtar. Më vjen mirë që pothuajse për pjesën dërmuese të tyre jepni dakordësinë në parim. Ndaj, me këtë projektligj, Akademia e Shkencave, jo vetëm që bën rregullimin juridik të statusit, por ju çon në pozicionin që meritoni.

Ju faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Beqiraj!

A ka ndonjë nga anëtarët që do të thotë diçka? Nuk ka.

Atëherë mund t'i drejtohem sërish zotit Toke dhe trupës së akademikëve të pranishëm.

A e keni lexuar ndonjëherë platformën “Fuga”? A mendoni se ka ndonjë defekt apo jo lidhur me këtë projektligj? A sjell ndonjë risi? A ka ndonjë të metë? A ka një vendim së

bashku me një numër protokolli, ku një platformë e tillë është shqyrtuar në mbledhjen e asamblesë së Akademisë? Pra, a është shqyrtuar ndonjëherë platforma “Fuga” në mbledhjet e asamblesë?

Urdhëroni, zoti Tole!

Vasil Tole – Zonja kryetare, siç e thashë, ky projektligj është hartuar nën këndvështrimet dhe paraqitjen e platformave të pothuajse secilit prej anëtarëve të Akademisë së Shkencave, pasi çdo akademik, për vlerat që paraqet për personalitetin që ka, është në gjendje të imagjinojë dhe të ndërtojë strukturën e një akademie sipas vizionit të vet. Projektligji është hartuar, në radhë të pare, mbështetur mbi alternativat dhe jo mbi një porosi fikse. Në rast se do t’i referoheni platformës “Fuga”, dhe më lejoni t’ju citoj një material të botuar nga Akademia, ku shkruhet e gjithë ecuria e reformës, në mbledhjen e datës 5 nëntor, të cituar nga relatori, mbështetur dhe në porosinë e zotit Kryeministër, e gjithë asambleja e Akademisë, me prezencën e zotit Fuga, u mblodh për të diskutuar pasurimin e mëtejshëm që mund t’i bëhej projektligjit të hartuar nga grupi i punës.

Në atë mbledhje, dhe mund ta lexoni edhe në procesverbal, të cilit ju me të drejtë i jepni rëndësi, pasi aty është shkruar gjithçka që u tha atë ditë, grupi i punës konkludoi si vijon: “Gjithçka është e mundur të përfshihet në projektligj, përveç një pike, e cila është zemra e platformës “Fuga””. Kjo është një pikë të cilën ne, si grup pune, nuk e merrnim dot përsipër, pasi ishte një çështje që lidhej me politikën, ishte çështja e heqjes së të drejtës së votës akademikëve tashmë jo mbi 75 vjeç, por mbi 68 vjeç. Në këtë pikë ne u ndamë dhe asambleja ka vendosur në mënyrë unanime mbështetjen e draftit të grupit të punës. Në rast se doni të dini më shumë se çfarë është thënë atë ditë, unë po e lë këtë libër për ju, që ta lexoni.

E ritheksoj që ky projektligj nuk ka lënë jashtë neneve të tij asnjë detyrim të rëndësishëm që duhet të zhvillojë Akademia e Shkencave në të ardhmen.

Në mbledhjen e zgjeruar të datës 5 nëntor, ky projektligj u diskutua me prezencën e zotit Fuga dhe pasi u votua, e vetmja votë kundër ishte vota e tij, i cili rithekson se kemi të bëjmë me dy modele parimisht të kundërta dhe të paintegruara. U mbyll kjo çështje dhe projektligji vazhdoi procedurën e vet, por ne e bëmë detyrimin tonë për ta bërë konsultimin publik në prezencë të të gjithë asamblesë. Mendoj se duhet t’ju thotë diçka fakti që 43 anëtarë votojnë për këtë draft dhe vetëm 1 është kundër. Kjo është demokracia, kjo është vota.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – A ka të tjera diskutime?

Zoti Shtino, ju lutem, nëse do të ishte e mundur nga ju, të depozitohen pranë nesh, po ju praqes një kërkesë nga ana ime, të gjitha mendimet e katedrës së departamenteve, universiteteve dhe rektorëve, lidhur me projektligjin, për risitë apo të metat e tij.

Redi Shtino – Po, patjetër, do t’jua depozitojmë...

Fatjona Dhimitri – Unë e kërkoj edhe nga zoti Shtino këtë.

Redi Shtino – Do t’jua depozitojmë sa më shpejt.

Fatjona Dhimitri –Faleminderit!

Të nderuar profesorë, ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në seancën e sotme të dëgjesave. Faleminderit!

Mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

Milva Ekonomi – Mbase duhet të diskutojmë edhe disa çështje të brendshme, zonja kryetare.

Fatjona Dhimitri – Në rregull.

(Diskutime pa mikrofon)

Milva Ekonomi –Muhamet, nesër në orën 10:00 kemi rektorët.

(Diskutime pa mikrofon.)

Muhamet Bela - I kemi njoftuar të gjithë rektorët.

Fatjona Dhimitri – Po jua them unë, se kam folur vetë me rektorët. Rektorja e universitetit të Durrësit, Ksanela do të vijë; rektori i universitetit të Shkodrës do të vijë; rektori i universitetit të Elbasanit do të vijë... I kam këtu të gjitha kontaktet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe të Vlorës dhe të Gjirokastrës më the që do të vijnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Profesor Mynyri më ka thënë... Nesër do të vijë profesor Romeo Hanxhari, nga Fakulteti i Histori-Filologjisë, përgjegjës i departamentit...

Milva Ekonomi – A është antar senati professor Hanxhari?

Fatjona Dhimitri – Po.

Milva Ekonomi – Po të mos jetë në senat, nuk e pranojmë dot...

Fatjona Dhimitri – Rektori i Universitetit të Mjekësisë, duke qenë se është jashtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Konfirmoje nëse është në senat...

Fatjona Dhimitri – Më duket se është në senat. Shikoje një herë!

Milva Ekonomi – Duhet kontrolluar, se nuk mund të vijë dikush që nuk është në senat.

Fatjona Dhimitri – Ia kam bërë këtë pyetje dhe më tha që është...

Milva Ekonomi – Sidoqoftë, duhet kontrolluar.

Fatjona Dhimitri – Fakulteti i Histori-Filologjisë, përgjegjës departamenti i Gjeografisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Po Fugën e lajmëruat?

Fatjona Dhimitri – Profesor Fuga do të vijë pasnesër, ditën e premte...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Të premten jo! Nesër është e mërkurë, maksimumi pasnesër do të mbylлим dëgjesat...

Fatjona Dhimitri – Unë e kam pyetur, por duke ditur që dje ai ishte gjithë ditën në provim...

Milva Ekonomi – Jo të premten. Nuk mund të bëhet presion mbi komisionin!

Fatjona Dhimitri - Milva, nuk është presion, por duke qenë se... Edhe sot ai tha: “Do të vij, por kam provim gjatë gjithë ditës.”

Milva Ekonomi - Edhe ne kemi zona... Është e ndarë që në krye të herës që e premtja është ditë pune në zona për antarët e komisionit.

Fatjona Dhimitri – Në çfarë ore mund të vijë nesër Fuga?

Milva Ekonomi – Mbas rektorëve.

Fatjona Dhimitri – Në orën 12:00, nëse është e mundur, se, me sa di unë, ka pasur provime...

Milva Ekonomi – Ne ia japim oraret kur të dojë, ndërkohë thoni të premten, që ne e kemi ditë zone.

(Diskutime pa mikrofon.)

Për t’jua sqaruar edhe një herë: ne e kemi bërë diskutimin në parim. Duhet të keni parasysh që kemi projektligjin e depozituar nga nismëtarët, komentet për çdo nen nga Këshilli i Ministrave, komentet e ardhura nga të pavarurit, siç janë Aurela Anastasi, Eglantina Gjermani...

Nëse dikush nga ju ka komente për nenet, t’i depozitojë në sekretari, që të fillojë puna për projektligjin, se duhet bërë një projektligj i mirë, para se të shkojë në parlament. Duhet ta kemi parasysh këtë gjë. Kush ka komente për nenet, bashkë me mua, duhet t’i depozitojë në sekretari.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duhet të fillojë puna. Relatori këtë punë ka.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nesër në orën 10:00.

Për dëgjesat kemi parashikuar dy profesorë të pavarur, profesor Fugën dhe professor Haxhimihalin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pyeteni edhe njëherë professor Haxhimihalin, nëse do të vijë për dëgjesë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nesër do të mbyllim dëgjesat. Muhameti do të flasë me Fugën dhe Haxhimihalin.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ne e morëm vendimin. Nesër në orën 10:00 do të jenë rektorët. Mbas rektorëve do të jetë Fuga dhe mbas tij do të vijë Haxhimihali.

MBYLLET MBLEDHJA

